




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 29.09.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.09.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 829, të datës 17.09.2020, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2021


1. Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2021, në shumë të përgjithshme prej 10,992,686.00€, i shpërndarë nëpër programe e nënprograme të kategorive ekonomike si vijon:
 - 1.1 Për paga dhe mëditje për 772 të punësuar në Administratën Komunale, Arsim dhe Shëndetësi, buxheti i komunës është në shumë prej: 5,096,346.00€;
 - 1.2 Për mallra dhe shërbime, buxheti i komunës është në shumë prej: 1,712,671.00€;
 - 1.3 Për shpenzime komunal, buxheti i komunës është në shumë prej: 250,000.00€;
 - 1.4 Për subvencione e transfere, buxheti i komunës është në shumë prej: 355,000.00€;
 - 1.5 Për shpenzime në projekte kapitale, buxheti i komunës është në shumë prej: 3,578,670.00€.
2. Vlerësimet e hershme të caktuara me kufijtë për Buxhetin e Planifikuar me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin fiskal 2022, është në shumë të përgjithshme prej: 12,375,394.00€, me shumën e caktuar për projekte kapitale prej: 4,844,717.00€ dhe për vitin fiskal 2023, është në shumë të përgjithshme prej: 12,712,098.00€, me shumën e caktuar për projekte kapitale prej: 5,156,055.00€.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 01.10.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.09.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 150, të datës 06.02.2020, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete dhe rishqyrtimit sipas shkresës 1956/4, të datës 07.07.2020, të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, bazuar nënin 11, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (d), nenin 17, shkronja (b), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 19, paragrafi 3, të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233, (Gazeta Zyrtare 85/2010), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (b), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për shpalljen e lokalitetit Boshtres 'Forysthia Europea' në zonën e Goleshit në fshatin Harilaç në kategorinë monument i natyrës

Neni 1

Me këtë vendim shpallet nën mbrojtje Lokaliteti i Boshtres 'Forysthia Europea' në zonën e Goleshit në fshatin Harilaç të Fushë-Kosovës, në kategorinë Monument i Natyrës, në tekstin e mëtejme: Monument i Natyrës

Neni 2

Zona e mbrojtur si monument i natyrës që e përfshinë territorin në Komunën e Fushë-Kosovës është në sipërfaqe prej 51.92 ha, Boshtre 'Forysthia Europea', ndërsa paraqitja hartografike me përmasa 1:25000, paraqitet në shtojcën e bashkangjitur të këtij vendimi.

Neni 3

Ky vendim përfshinë sipërfaqën e zonës së mbrojtur të evidentuar në pikën dy të vendimit, të cilës i caktohen dhe vendosen kufijtë për territorin e mbrojtur në Zonën Kadastrale Harilaç të Komunës së Fushë-Kosovës në ngastrat kadastrale si vijon: 00658-9, 00660-0, 00665-1, 00665-2, 00665-3, 00665-4, 00666-1, 00666-2, 00666-3, 00666-4, 00745-0, 00746-0, 00747-0, 00748-0, 00749-0, 00750-0, 00751-0, 00752-0, 00753-0, 00754-0, 00755-0, 00756-0, 00757-0, 00758-0 dhe pjesëve të ngastrave kadastrale 00656-1 dhe 00761-0.

Neni 4

1. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III, të mbrojtës në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese sipas të cilave në Monumentin e Natyrës ndalohen:
 - 1.1 shfrytëzimi i resurseve natyrore;
 - 1.2 prerja e trungjeve dhe çfardo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme;
 - 1.3 ndezja e zjarrit në sipërfaqën e mbrojtur;
 - 1.4 ndryshimi i pamjes së sipërfaqës së mbrojtur;
 - 1.5 hedhja e mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur;
 - 1.6 aktivitete tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.
2. Për Monumentin e Natyrës lejohen:
 - 2.1 të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes së Monumentit të Natyrës.

Neni 5

1. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Fushë-Kosovës përmes Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe është e detyruar që:
 - 1.1 Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;
 - 1.2 Në rast të paraqitjes së ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës, munden ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroi Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;
 - 1.3 Të bëjë shënimin e kufijëve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për shënimin e zonave të mbrojtura.

Neni 6

Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet bazat ekonomike-pyjore duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e monumentit të natyrës.

Neni 7

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Gjeodezisë Kadastrit e Pronës, Drejtoria e Planifikimit Urban, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit dhe Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 8

Ky vendim pas hyrjes në fuqi, duhet të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 9

Ky vendim i dërgohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit dhe Institutit Kombëtar për Mbrojtjen e Monumenteve me qëllim të regjistrimit në Regjistrin e vlerave të mbrojtura të natyrës.

Neni 10

Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së SHPM, Drejtorisë së BZHR dhe Arkivës.


**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.08.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.07.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 616, të datës 28.07.2020, paraqitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (r), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (m, n), nenin 27, shkronja (ç, nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës së Sporteve në fshatin Sllatinë e Vogël

1. Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës së Sporteve, në vendin të pishat në fshatin Sllatinë e Vogël, në ngastrën kadastrale Nr. 00443-1 me sipërfaqe prej: S=04.53.93ha, në Zonën Kadastrale Sllatinë e Vogël, sipas situacionit të përgatitur gjeodezik dhe grafikë për ndërtimin e objektit dhe hapësirën e lirë.
2. Ndërtimi i Palestrës së Sporteve do të realizohet me financimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në shumën e përgjithshme të mjeteve financiare prej: 1,800,000.00€, në periudhën kohore buxhetore 2020-2023.
3. Kryerja dhe mbikëqytja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të: Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban, Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit e Pronës dhe Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sport.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.


Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së KRS dhe Arkivës.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 02.10.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.09.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 379, të datës 14.02.2020, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, bazuar nenin 11, nenin 17, shkronja (e), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 4, paragrafi 1 dhe 2, Nr. 03/L-015, nenin 28, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (Gazeta Zyrtare 50/2009), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (d), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për fillimin e procedurës për përgatitjen e Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal

1. Për lejimin e fillimit të procedurës për përgatitjen e Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha

